

FORMULARI 2 - VENDIM PER SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PER MBESHTETJE  
FINANCIARE PUBLIKE PER PROJEKTE/PROGRAME TE ORGANIZATAVE JO-  
QEVERITARE

KOMUNA E DRAGASHIT



Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetqeverisje Lokale 031-40, dhe nenit 12 të rregullorës mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

**VENDIM**

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e Kulturës.

**I**

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullorës mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Zyrës së Kryetarit, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nenprogramit 160/16009 dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit e nënprogramit 850/85009.

**II**

2. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

### III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
  1. Teksti i thirrjes publike
  2. Udhëzimet për aplikantët
  3. Formularët e aplikimit
  4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
  5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
  
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin e këtij neni janë:
  1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
  2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
  3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
  4. Deklaratat e Partneritetit (nese EshtE e aplikueshme)
  5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
  6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
  
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin I të këtij neni janë:
  1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
  2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
  3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

### IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare: <https://kk.rks-gov.net/dragash/category/shpalljet/thirrje-per-propozime>

### V

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.



2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit I të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

#### VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Dreitoria per Kulture Rini dhe Sport

#### VII

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Udhëheqësi i institucionit

Emri i plotë dhe pozita

Shaban Shabani, Kryetar



*Shaban Shabani*

20.01.2020

